

LIGJ
Nr.9737, datë 17.5.2007

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.8560, DATË 22.12.1999 “PËR
PROCEDURAT TATIMORE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime e shtesa:

Neni 1

Neni 30 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 30

1. Subjektet që ushtrojnë veprimtari ekonomike tregtare, detyrohen të regjistrohen pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, në përputhje me dispozitat e ligjit për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Regjistrimi pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit përbën, njëkohësisht, edhe regjistrim në organet tatimore përkatëse.

2. Punonjësit e administratës tatimore kryejnë evidentimin e tatimpaguesve, që kryejnë veprimtari ekonomike tregtare pa u regjistruar, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.”.

Neni 2

Neni 31 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 31

Subjektet që ushtrojnë veprimtari ekonomike tregtare, çregjistrohen sipas dispozitave të këtij ligji dhe procedurave të përcaktuara me ligj të veçantë për regjistrimin e subjekteve. Një subjekt, i cili e vazhdon veprimtarinë edhe pas çregjistrimit, është objekt i masave ndëshkuese, sipas dispozitave të këtij ligji.”.

Neni 3

Pas nenit 32 shtohet neni 32/1 me këtë përmbajtje:

“Neni32/1

1. Subjektet e regjistruara pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit çregjistrohen nga regjistri tregtar pasi të kenë paguar të gjitha detyrimet tatimore të papaguara dhe pasi të kenë paraqitur bilancin e mbylljes për subjektet, për të cilat, sipas legjislacionit në fuqi, kërkohet paraqitja e bilancit.

2. Qendra Kombëtare e Regjistrimit njofton organin tatimor përkatës për regjistrimin e hapjes së procedurave të likuidimit apo për kërkesën për çregjistrim të personit fizik. Organi tatimor përkatës, brenda 45 ditëve nga data e këtij njoftimi, është i detyruar të verifikojë situatën tatimore dhe, kur është e nevojshme, të ushtrojë kontrollin në vend të veprimtarisë së subjektit.

3. Qendra Kombëtare e Regjistrimit nuk mund të kryejë çregjistrimin nëse organi tatimor përkatës, brenda 45 ditëve nga marrja e njoftimit, sipas pikës 2 të këtij neni, paraqet kundërshtime për çregjistrimin e subjektit. Kundërshtimi për çregjistrimin e subjektit nga regjistri tregtar duhet të përmbajë shumën e detyrimeve tatimore, të gjobave dhe interesave të papaguar.

4. Nëse, pas 45 ditëve nga data e njoftimit, organi tatimor përkatës nuk ka paraqitur ndonjë kundërshtim me shkrim apo kundërshtimi nuk përmban shumën e detyrimeve tatimore, të gjobave dhe interesave të papaguar, Qendra Kombëtare e Regjistrimit kryen menjëherë çregjistrimin e subjektit.

5. Pasi subjekti ka shlyer të gjitha detyrimet tatimore, gjobat dhe interesat e papaguar deri në datën e hapjes së procedurave të likuidimit apo të kërkesës për çregjistrim, organi tatimor përkatës detyrohet të tërheqë kundërshtimin për çregjistrim dhe Qendra Kombëtare e Regjistrimit kryen menjëherë çregjistrimin e subjektit.

6. Nëse, pavarësisht shlyerjes, organi tatimor përkatës nuk ka tërhequr kundërshtimin, atëherë subjekti mund t'i paraqesë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dokumentin, i cili vërteton shlyerjen e shumës së përgjithshme të detyrimeve tatimore, të gjobave dhe interesave të përcaktuar, në kundërshtimin për çregjistrim. Në këtë rast, Qendra Kombëtare e Regjistrimit kryen menjëherë çregjistrimin e subjektit dhe njofton organin tatimor përkatës.

7. Pavarësisht nga sa më sipër, çregjistrimi, në çdo rast, nuk eliminon detyrimin tatimor të mbetur.”.

Neni 4

Pas nenit 49 “Shkeljet dhe dënimet në lidhje me regjistrimin” shtohet neni 49/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 49/1

Shkeljet dhe dënimet për subjektet që regjistrohen në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit

1. Përveç sanksioneve administrative, të parashikuara nga ligji për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, kryerja e veprimtarisë ekonomike tregtare pa regjistrim nga subjektet që duhet të regjistrohen pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, përbën shkelje administrative dhe dënohet nga organet tatimore përkatëse si më poshtë:

a) me bllokim të veprimtarisë deri në çastin e regjistrimit, sipas dispozitave të ligjit për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

b) me sekuestrim të pasurive në vendin e biznesit, nëse tatimpaguesi i paregjistruar, ndaj të cilit është marrë masa e bllokimit, vazhdon ushtrimin e veprimtarisë, pavarësisht urdhrit për bllokim.

2. Përveç sanksioneve administrative, të parashikuara nga ligji për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, kryerja e veprimtarisë ekonomike tregtare në një vend të ushtrimit të veprimtarisë, adresa e të cilit nuk është regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, përbën shkelje administrative dhe dënohet nga organet tatimore përkatëse si më poshtë:

a) me bllokim të veprimtarisë deri në regjistrimin e adresës së re të vendit të ushtrimit të veprimtarisë, sipas dispozitave të ligjit për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

b) me sekuestrim të pasurive në vendin e ri të biznesit, nëse tatimpaguesi, ndaj të cilit është marrë masa e bllokimit, pavarësisht urdhrit të bllokimit, vazhdon ushtrimin e veprimtarisë në adresën e paregjistruar.

3. Pavarësisht nga sanksionet e mësipërme, subjektet e paregjistruara, sipas përcaktimeve të pikave 1 e 2 të këtij neni, mbeten të detyruara të paguajnë detyrimet tatimore, në përputhje me legjislacionin në fuqi, për të ardhurat e përfituara nga kryerja e veprimtarisë së paregjistruar.”.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5337, datë 31.5.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**